

VENDIM
Nr.1025, datë 15.12.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1642, DATË 11.12.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE
NË PËRDORIM TË BASHKISË PËRRENJAS TË QARKUT TË ELBASANIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për një ndryshim në listën përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë së Përrenjasit të qarkut të Elbasanit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1 dhe formularëve, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Përrenjasit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Përrenjas

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
212	Truall	Në pronësi
858, 862	Infrastrukturë dhe shërbime publike	Në pronësi